



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 13

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 19.4.2002	Me objekt interpretimin përfundimtar të neneve 128, 140, 149 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë 387
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 76, datë 25.4.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.20, datë 19.3.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të Dekretit nr.3276, datë 25.3.2002 të Presidentit të Republikës..... 395

V E N D I M
Nr. 75, datë 19.4.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Tefta Zaka,	Anëtare e ““
Petrit Ploçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 25.03.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.59 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lekë Çukaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.
2. PRESIDENTI I REPUBLIKËS, në mungesë.
3. GJYKATA E LARTË, përfaqësuar nga avokat Krenar Loloçi.
4. PROKURORI I PËRGJITHSHËM, zoti Arben Rakipi.

OBJEKTI: Interpretimi përfundimtar i neneve 128, 140, 149, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Interpretimin përfundimtar të neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës, të cilat parashikojnë rastet e shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, kërkuesi e ka kufizuar kryesisht në interpretimin e dy momenteve kryesore që kanë të bëjnë:

- me kuptimin e shkaqeve dhe të motiveve të shkarkimit që lidhen me termat kushtetuese “akte e sjellje që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën...” e gjyqtarit e të prokurorit, si dhe “shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve...” nga Prokurori i Përgjithshëm;

- me kuptimin e procedurave që duhet të ndjekë dhe respektojë Kuvendi për verifikimin dhe vërtetimin e shkaqeve për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Kërkuesi pretendon se procedura që duhet të ndjekë Kuvendi në këto raste ndikon drejtpërdrejt në garantimin e statusit kushtetues të këtyre organeve dhe mosrespektimi i rregullave të saj mund të krijojë precedentë të rrezikshëm për respektimin e Kushtetutës.

Përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë, parashtrroi pretendimet e tij vetëm për kuptimin kushtetues të nenit 140, duke u përqëndruar në këto momente:

- Përmbushja nga ana e Kuvendit e detyrës për të provuar dhe vërtetuar nëse ekziston ndonjë nga shkaqet që parashikohen në Kushtetutë për të vendosur shkarkimin e gjyqtarit, i jep veprimtarisë së tij disa tipare të ngjashme me veprimtarinë gjyqësore, pra ai kryen një veprimtari quasi gjyqësore;

- Angazhimi i Kuvendit në seancat plenare për të shqyrtuar shkeljet e kryera nga një gjyqtar pa u shoshitur më parë në komisionet ad hoc të Kuvendit, përgjithësisht mund të çojë në marrje vendimesh të nxituara dhe të pabazuara juridikisht;

- Pavarësisht se procedura për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është e mangët ajo nuk mund të mbushet me asnjë lloj vendimi gjyqësor.

Prokurori i Përgjithshëm, e përmbloodhi opinionin e tij kryesisht në procedurën që kishte ndjekur Kuvendi gjatë seancës plenare të marrjes së vendimit për propozimin për shkarkim të Prokurorit të Përgjithshëm.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit, të subjekteve të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkesa e një grupi deputetësh, të cilët përbëjnë jo më pak se një të pestën e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, ka për objekt interpretimin e neneve kushtetuese që parashikojnë rastet se kur mund të shkarkohen gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Arsyen e paraqitjes së kërkesës, kërkuari e ka motivuar me faktin se në praktikën parlamentare të mëparshme janë krijuar keqkuptime, të cilat kanë sjellë dhe moszbatimin në të njëjtën mënyrë të procedurave për shkarkimin e këtyre funksionarëve të lartë.

Kërkuari, në kërkesë, i referohet procedurave që janë ndjekur gjatë një mocioni të paraqitur para afro një viti për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe të mocionit për shkarkimin e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ndaj të cilëve Kuvendi ka mbajtur një qëndrim konkret. Në seancën gjyqësore, përfaqësuesi i kërkuarit ju referua gjithashtu, duke shprehur kundërshtimet e tij edhe procedurës që kishte ndjekur Kuvendi gjatë shqyrtimit të mocionit të paraqitur lidhur me propozimin për shkarkim të Prokurorit të Përgjithshëm gjatë së cilës, sipas tij, janë shfaqur mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin e dispozitës si në kuptimin material ashtu edhe procedural.

Qëndrimet që ka mbajtur Kuvendi në të gjitha rastet që lidhen me procedurat e shkarkimit të këtyre funksionarëve të lartë, të cilat kanë marrë një zgjidhje përfundimtare pasi janë konkretizuar me vendime, janë konsideruar për kërkuarin si mënyra të ndryshme interpretimi të neneve 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës.

Grupi i deputetëve, duke mos qenë i qartë për nenet kushtetuese të sipërcituara, por duke patur edhe një mendim të ndryshëm për kuptimin e shkaqeve kushtetuese, si dhe të procedurës që duhet ndjekur në këto raste, ka kërkuar kryerjen e interpretimit përfundimtar të këtyre dispozitave të Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese.

Në këto kushte:

- përderisa nga praktikat e mëparshme parlamentare dhe qëndrimet që janë mbajtur rezulton se dispozitave konkrete të Kushtetutës i janë bërë interpretime që shprehen nëpërmjet vendimeve të Kuvendit;

- duke qenë se për këto dispozita ka edhe një qëndrim tjetër të ndryshëm nga i pari, i shprehur në kërkesën e një grupi deputetësh të Kuvendit, të cilët kanë inicuar këtë proces kushtetues,

Gjykata Kushtetuese konkludon se kryerja e një interpretimi përfundimtar të neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës bëhet e domosdoshme pasi krijon mundësinë e mënjanimin të mosmarrëveshjeve apo paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre.

Nenet 128 dhe 140 të Kushtetutës kanë formulime të njëjta, sepse përmbajnë katër shkaqe kushtetuese, në të cilat duhet të bazohet Kuvendi për të motivuar vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, ndërsa neni 149 pika 2 parashikon rastet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, nga të cilat vetëm njëri prej tyre është i ndryshëm nga të parat.

Nga të gjitha shkaqet për shkarkim të këtyre funksionarëve të lartë që parashikohen në këto nene kushtetuese, dy prej tyre dhe konkretisht “kryerja e një krimi” dhe “paaftësia mendore a fizike”, janë të tilla që nuk mund të vërtetohen drejtpërdrejt nga Kuvendi, pasi ato kërkojnë që paraprakisht të konstatohen dhe të vërtetohen nga organe kompetente.

Çështja paraqitet më e vështirë në aspektin e interpretimit të koncepteve kushtetuese si akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit e të prokurorit si dhe shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve nga Prokurori i Përgjithshëm.

Për interpretimin e këtyre normave, Gjykata Kushtetuese nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit pozitiv, duke parashikuar një për një të gjitha rastet që mund të përfshihen në këto shkaqe kushtetuese, sepse do të ishte e pamundur një gjë e tillë ndërkohë që Kushtetuta, ligjet, apo edhe vendimet gjyqësore nuk mund të kodifikojnë me saktësi aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit a prokurorit, apo rastet se kur ligji është shkelur rëndë.

Interpretimi që Gjykata Kushtetuese i bën dispozitave apo termave konkrete të Kushtetutës ka për qëllim që në mënyrë analitike të jap dhe të përcaktojë kriteret, konceptet bazë si dhe parimet mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë si dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Veprimet apo mosveprimet e këtyre funksionarëve të lartë të shtetit, të cilat mund të përfshihen në shkaqet kushtetuese që shërbejnë për shkarkimin e tyre, janë të tilla që mund të vlerësohen rast pas rasti nga vet organi që kryen këtë procedurë shkarkimi. Megjithatë, në çdo rast, ato janë të lidhura me sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës, me abuzimin apo dhunimin që ata i bëjnë besimit publik dhe që lidhen kryesisht me dëmet që ata i sjellin shoqërisë dhe shtetit. Aktet dhe sjelljet e padenja që ata kryejnë duhet të jenë aq serioze, të kenë diskredituar aq rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit apo prokurorit dhe të kenë ulur dinjitetin e organit që përfaqësojnë, sa të detyrojnë organin kompetent për të marrë masën e largimit nga detyra.

Nisur nga përmbajtja e nenit 149 pika 2 të Kushtetutës, që parashikon ndërmjet shkaqeve të tjera për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm edhe shprehjen “shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij”, Gjykata Kushtetuese arsyeton se kuptimi i saktë dhe i drejtë i saj i përdorur në këtë dispozitë kushtetuese, por edhe në të tjera, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur. Gjithashtu, cilësimi “rëndë”, i përdorur si për rastin e diskreditimit të pozitës dhe figurës së gjyqtarit e të prokurorit, ashtu dhe të shkeljes së ligjit, i shërben njëkohësisht organit kompetent që fillon procedurat e shkarkimit për të dalluar këto veprime nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të motivuar shkakun e shkarkimit.

Mënyra e formulimit në Kushtetutë të shkaqeve për shkarkim, duket sikur e lë të hapur dhe të diskutueshme bërjen e interpretimeve pa fund të rasteve që mund të klasifikohen nga praktika parlamentare si shkelje e rëndë e ligjit, apo akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit e prokurorit. Megjithatë, jurisprudenca gjyqësore dhe veçanërisht shqyrtimi i deritanishëm apo edhe në të ardhmen nga Gjykata Kushtetuese i rasteve konkretë, të cilat lidhen me këto koncepte kushtetuese, sigurisht që do t'i japin një kuptim më të plotë dhe më të qartë këtyre shkaqeve kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në analizë të mëtejshme të këtyre koncepteve kushtetuese, çmon të nevojshme të argumentojë se kuptimi i termave kushtetues që lidhen me shkaqet e shkarkimit duhet parë i lidhur ngushtë me gjithë procesin ligjor që ndjek Kuvendi në rastet kur inicon procedurat për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nëse gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i Gjykatës së Lartë, apo Prokurori i Përgjithshëm rezulton se ka shkelur Kushtetutën, ka kryer akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij, apo ka shkelur rëndë ligjin, marrja e masës së shkarkimit nga Kuvendi është e lidhur domosdoshmërisht me kryerjen e procedurave përkatëse.

Funksioni që kryen Kuvendi në këtë rast është i një natyre të veçantë. Procesi i realizuar prej Kuvendit ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces ligjor që është një proces gjykimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkretë që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo prokurorit.

Dispozitat kushtetuese objekt interpretimi, janë materiale e proceduriale dhe kanë për qëllim të përcaktojnë në mënyrë taksative rastet klasike se kur mund të shkarkohen gjyqtarët apo Prokurori i Përgjithshëm. Ekzistenca e këtyre shkaqeve kushtetuese për shkarkim përbën një garanci më shumë për funksionet që ata kryejnë, por edhe për vet institucionet kushtetuese që ato përfaqësojnë.

Këto nene kushtetuese kanë lënë në vlerësimin e Kuvendit, si karakterin dhe rëndësinë e shkëljes së kryer, ashtu edhe faktin nëse akti apo veprimi, është i asaj natyre që mund të diskreditojë figurën e gjyqtarit apo të prokurorit. Ajo që nënkupton dispozita kushtetuese është që rasti konkret për shkarkim duhet të ketë ndodhur dhe të jetë i vërtetuar si i tillë.

Pikërisht ky konkluzion del nga interpretimi që i bëhet fjalisë së dytë në nenet 128 e 140. Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar vendimin e Kuvendit që ka shkarkuar gjyqtarin, vërteton nëse ekziston shkak i shkarkimit. Pra, ajo vërteton nëse Kuvendi ka vepruar në përputhje me Kushtetutën, rregulloren dhe me ligjet përkatëse dhe nëse ai i ka respektuar të gjitha procedurat për ta motivuar, argumentuar dhe arsyetuar plotësisht vendimin e shkarkimit.

Nëpërmjet këtij kontrolli konstitucional që kryhet mbi vendimin e Kuvendit, Gjykata Kushtetuese shqyrton jo vetëm procedurën e shkarkimit, por edhe thelbin e çështjes. Prandaj, me qëllim që vendimi i Kuvendit të jetë sa më i bazuar dhe të mos rrëzohet si antikushtetues, ai duhet të ketë plotësuar të gjitha elementet e domosdoshëm të një procedure korrekte, sepse mjafton mosrespektimi i procedurës dhe i formës së nxjerrjes së një akti, që ai të konsiderohet i pavlefshëm.

Përsa i përket nenit 149 pika 2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se është Presidenti i Republikës organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer një verifikim nga pikpamja kushtetuese të shkaqeve si dhe të procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Ky konkluzion del nga mënyra e formulimit të këtij neni kushtetues në të cilin, përdorimi i shprehjes “mund të shkarkohet”, do të thotë se vendimi i Kuvendit për propozimin e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk është përfundimtar, por është vetëm inicimi i një procedure shkarkimi, bazueshmëria në ligj dhe në Kushtetutë e të cilës vlerësohet në këtë rast nga Presidenti i Republikës.

Nisur nga sa u parashtrua më lart, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të verë në dukje se elementet bazë të një procedure ligjore, që lidhen me mënyrën e inicimit të procedurës për shkarkim, quorum-in e nevojshëm për vendimmarrjen, shkaqet ligjore për shkarkim, si dhe organin që vendos përfundimisht për to, janë të parashikuara përgjithësisht në Kushtetutë. Megjithatë një rregullim të mëtejshëm ato e gjejnë në ligjet bazë, siç është rasti i quorumit të domosdoshëm që nevojitet për inicimin e procedurave për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Përsa i përket anëtarëve të Gjykatës së Lartë nuk ka ndonjë rregullim ligjor për inicimin e procedurës për shkarkimin e tyre. Gjithashtu edhe për propozimin për shkarkim të Prokurorit të Përgjithshëm, Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nuk parashikon elementet bazë të procedurave. E vetmja referencë kushtetuese që mund të bëhet për këtë rast është neni 78 pika 1 e Kushtetutës, ku parashikohet rregulli i përgjithshëm, (me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar) lidhur me votat e nevojshme që i duhen Kuvendit për të marrë vendim.

Në kushtet kur në Kushtetutë, apo edhe në ligjet e tjera elementet thelbësorë të një procedure nuk gjejnë rregullim të hollësishëm, atëherë Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se këto rregulla proceduriale nuk mund të plotësohen nëpërmjet vendimit të saj interpretues. Interpretimi, si funksion dhe metodë, ka vend për një normë ekzistuese kur ka paqartësi në kuptimin e saj dhe jo për të plotësuar boshllëkun, sepse përndryshe Gjykata Kushtetuese do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike, funksion, që siç dihet, i përket ligjvënësit.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nënvizon se pavarësisht nga kjo mënyrë rregullimi në Kushtetutë apo në ligj të procedurave të shkarkimit të gjyqtarit apo prokurorit, kjo nuk e pengon Kuvendin të adoptojë rregulla të veçanta për çdo rast konkret, apo për të gjitha rastet në tërësi, por gjithmonë duke respektuar parimin kushtetues, atë të një procesi të rregullt ligjor.

Standartet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur vendin e tyre në Kushtetutë, si dhe një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, kanë përcaktuar dhe konsoliduar një sërë elementesh të procesit të rregullt ligjor, mungesa e të cilëve zhvlerësojnë si procedurat ashtu edhe vendimet e marra nga cilido organ. Argumentimi i shkeljeve që atribuohen, respektimi gjatë shqyrtimit i parimit të ndarjes së pushteteve, njohja paraprake e personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cënimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.

Nga e gjithë kjo analizë kushtetuese, e cila nuk krijon ndonjë normë të re juridike, por që përbën veçse një arsyetim logjik dhe interpretativ të neneve 128, 140 dhe 149, pika 2 në vështrim dhe me dispozitat e tjera të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenet 71, 72 e 79 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Interpretimin brenda kufijve të objektit të kërkesës të neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës në këtë mënyrë:

1. Shprehja “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 të Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilët mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padënja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.

2. Shprehja “shkelje e rëndë e ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve” nga Prokurori i Përgjithshëm, parashikuar nga neni 149, pika 2 të Kushtetutës lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur.

3. Në përcaktimin e procedurave të shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, organet përkatëse duhet të respektojnë rregullat për aq sa parashikohet në Kushtetutë, në ligjet organike të tyre si dhe në aktet e tjera ligjore. Në ndërmarrjen e procedurave për shkarkimin e këtyre funksionarëve, kusht thelbësor mbetet respektimi i të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

MENDIMI I PAKICËS

Çështja nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese për këto arsye:

1. Në bazë të nenit 124/1 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës që do të thotë se ajo e shqyrton çështjen pasi organi kompetent të ketë bërë një interpretim nëpërmjet marrjes së një vendimi ose të një akti. Por, kërkesa e një grupi deputetësh, është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese para se për çështjen në shqyrtim të vendoste Kuvendi si organ kompetent. Argumenti që përdoret në kërkesë se ndodhemi para qëndrimeve e interpretimeve të ndryshme, nuk qëndron. Fakti që një pjesë e deputetëve mund të kenë mendim të ndryshëm nga të tjerët (dhe kjo mund të jetë normale) nuk do të thotë se ka qëndrime e praktika të ndryshme të organit kompetent për shqyrtimin e çështjes, i cili është Kuvendi. Ky i fundit vendos sipas një procedure të caktuar me shumicë votash;

2. Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga grupi i deputetëve kërkohet të bëhet interpretimi përfundimtar i neneve 128, 140 dhe 149/2 të Kushtetutës, lidhur me kuptimin e procedurave që duhet të ndjekë dhe respektojë Kuvendi për verifikimin, hetimin dhe vërtetimin e shkaqeve të shkarkimit. Dy nenet e para kanë parashikuar si procedurë shkarkimin nga Kuvendi me dy të tretat e gjithë anëtarëve të tij, kurse neni 149/2 nuk shprehet për këtë, por sipas nenit 78 të Kushtetutës, Kuvendi vendos me shumicë të votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij. Procedurë tjetër Kushtetuta nuk përmend dhe për këtë Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjë interpretim, por do të zbatohet drejtpërdrejt Kushtetuta. Përmendja e parimeve të procesit të rregullt ligjor nuk është interpretimi për procedurat që duhen zbatuar në raste të tilla, por një deklaram i panevojshëm dhe që nuk i përgjigjet shkaqeve të kërkesës. Në kërkesë, kërkohet të interpretohet lidhur me procedurat e verifikimit etj., dhe jo interpretimi në përgjithësi. Por, përderisa Kushtetuta ka caktuar ato procedura që ka parë të nevojshme, Gjykata Kushtetuese nuk mund të shtojë të tjera me interpretim, sepse do të dilte jashtë tekstit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe njëkohësisht jashtë kompetencave të saj.

3. Përsa i përket shkaqeve të shkarkimit, ndonëse nga pikëpamja formale mund të bëhet interpretim se ç'kuptohet me shprehjet "shkelje e Kushtetutës", "kryerje e një krimi", apo "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën", etj., këtë e bën çdo organ kompetent që zbaton Kushtetutën dhe përfundimisht mund ta bëjë Gjykata Kushtetuese. Por, përderisa nuk ka një interpretim tjetër të mëparshëm nga një organ kompetent, Gjykata Kushtetuese nuk bëhet kompetente për të bërë interpretimin përfundimtar, në bazë të nenit 124/1 të Kushtetutës. Gjykatës Kushtetuese nuk i lejohe kryerja e çdo lloj interpretimi të dispozitave të Kushtetutës, por vetëm interpretimi përfundimtar i tyre, sipas nenit 124/1 të Kushtetutës.

ANËTAR

K. Peçi

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me vendimin për arsyet që vijonë:

Rezerva ime ka të bëjë me mungesën e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës së jo më pak se 1/5 e Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt interpretimin e neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës.

Kërkesa e mësipërme e deputetëve e mbështet kompetencën e kësaj Gjykate në nenin 124 të Kushtetutës, sipas të cilës: "Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj".

Mendoj se kjo dispozitë nuk rregullon kompetencat konkrete që Kushtetuta i ngarkon Gjykatës Kushtetuese, por si dispozitë e parë e bllokut të dispozitave që rregullojnë pozitën e saj si organ kushtetues, qëllimi i saj është të përcaktojë në esencë funksionin themelor të kësaj Gjykate - garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj, ndërsa rastet se kur kjo Gjykatë investohet për të realizuar funksionin e saj interpretues, specifikohen në dispozita të tjera.

Po të ishte se kjo dispozitë do të kishte për qëllim caktimin e kompetencës, nuk kishte pse rastet e interpretimit t'i specifikonte në dispozita të tjera, por një gjë e tillë do të bëhej pikërisht këtu. Përkundrazi, në këtë dispozitë vetëm sa hidhet ideja e kompetencës interpretuese – si funksion themelor i Gjykatës Kushtetuese, por nuk specifikohen rastet se kur investohet kjo Gjykatë për ushtrimin e këtij funksioni. Për më tepër, në këtë dispozitë, në paragrafin e dytë të saj, sanksionohet edhe se “Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës”. Pra, përveçse përcakton në esencë dhe në vija të përgjithshme funksionin themelor të saj, neni 124 sanksionon edhe bazën normative të aktivitetit të kësaj Gjykate. Po të ishte konceptuar kjo si një dispozitë që specifikonte kompetencat e gjykatës, atëherë nuk kishte pse në të të rregullohej edhe baza normative e aktivitetit të kësaj gjykate.

Mendoj se, dispozita ku përcaktohet gama më e madhe e kompetencave interpretuese të Gjykatës Kushtetuese është neni 131 i Kushtetutës. Përveç rasteve të përcaktuara në këtë dispozitë, kjo Gjykatë i ka këto kompetenca edhe në raste të tjera që parashikon Kushtetuta, të tilla si në nenet 115, 128 të saj, etj.. Neni 131 parashikon disa raste kur mund të kërkohet interpretimi. Në kërkesë nuk është përmendur asnjëri nga këto raste. Për pasojë, as kjo dispozitë, ashtu si neni 124, nuk mund të shërbejë si bazë juridike për marrjen në shqyrtim të kërkesës.

Në vendim, ekzistenca e kompetencës së Gjykatës, është motivuar me interpretimet e ndryshme nga ana e Kuvendit, që u është bërë dispozitave, për të cilat është kërkuar interpretimi. Por, edhe këtë rast Kushtetuta nuk e “njuh” si shkak për të investuar Gjykatën Kushtetuese për të bërë interpretimin. Po të shihet neni 131 që përmendëm edhe më sipër, interpretimet e ndryshme të Kushtetutës, të bëra nga i njëjti organ, në praktikën e aktivitetit të tij, siç janë në rastin në shqyrtim interpretimet e ndryshme të bëra nga ana e Kuvendit, nuk përmenden në këtë dispozitë si raste që investojnë Gjykatën Kushtetuese për interpretim. Dispozita e mësipërme, në shkronjën “ç” e ngarkon Gjykatën Kushtetuese të vendosë për “mosmarrveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve...”, pra, kur pushtete të ndryshëm i interpretojnë në mënyra të ndryshme dispozitat kushtetuese, por jo në rastin kur i njëjti organ, gjatë aktivitetit të tij, mban qëndrime jokohereente në aplikimin e dispozitave kushtetuese. Pra, përdërisa Kushtetuta i specifikon rastet e interpretimit, një gjë e tillë nuk mund të kërkohet jashtë këtyre rasteve. Kushtetuta, duke numëruar rastet se kur investohet Gjykata për interpretim, ka “nënkuptuar” se një gjë e tillë nuk mund të bëhet pa lindur nevoja e interpretimit. Dhe rastet se kur lind kjo nevojë Kushtetuta i ka caktuar “vetë” dhe nuk i ka lënë në diskrecionin e gjykatës.

Një qëndrim tjetër mbante në këtë drejtim ligji nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Sipas Nenet 24 të këtij ligji, “Gjykata Kushtetuese ka këto kompetenca: 1.Bën interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese; 2.Gjykon papajtueshmërinë e ligjeve dhe të akteve që kanë fuqinë e ligjit me Kushtetutën; 3.Gjykon papajtueshmërinë e akteve dhe dispozitave nënligjore me Kushtetutën dhe me ligjin; ... etj.” Pra, siç shihet, në këtë dispozitë, ndryshe nga neni 131 i Kushtetutës, ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” njihet si kompetencë të Gjykatës Kushtetuese edhe interpretimin e Kushtetutës pa konkuruar ndonjëri nga rastet e parashikuara në të.

Mendoj se interpretimi i Kushtetutës nuk është qëllim në vetvete. Nga ana tjetër, interpretimet e llojit të nenit 24, mund të jenë jashtë kontekstit të nevojave që shtron praktika. Duke qenë të tilla, këto lloj interpretimesh janë të vështira dhe mund të çojnë edhe në qëndrime jokohereente. Përkundrazi, interpretimi i Kushtetutës, i nxitur nga nevoja, mund ta bënte këtë edhe më të lehtë. Prandaj, mendoj se edhe për këto arsye, pika 1 e nenit 24 të sipërpërmendur nuk është parashikuar më në nenin 131 të Kushtetutës, siç parashikohej në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Duke qenë jashtë kontekstit të nenit 131, atëherë çfarë i është kërkuar Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet kërkesës së mësipërme, ç'karakter ka kjo kërkesë?.

Mendoj se në esencë Gjykatës i është kërkuar dhënia e një mendimi (opinion) të karakterit konsultativ. Kjo gjë rezulton si nga përmbajtja e kërkesës ashtu edhe nga rrethanat e çështjes, që po i paraqes shkurt: Kështu, para disa kohësh, Kuvendi inicon procedurën për të paraqitur një propozim – shkarkimi, në bazë të nenit 149 pika 2 të Kushtetutës.

Pikërisht, në këtë kohë, pa u finalizuar propozimi, nga jo më pak se 1/5 e deputetëve paraqitet kërkesa për interpretimin e dispozitave të mësipërme, duke e motivuar atë me qëndrime të ndryshme të Kuvendit në raste të kësaj natyre. Pikërisht, për këtë shkak, kërkohet një mendim nga Gjykata Kushtetuese para se Kuvendi të vendoste për propozimin për shkarkim. Pikërisht këto rrethana, e kategorizojnë këtë kërkesë në llojin e kërkesave për mendim konsultativ.

Kushtetuta jonë nuk e “njuh” mundësinë e paraqitjes të këtyre kërkesave, ndonëse jo në shumë raste, ka Kushtetuta të vendeve të tjera që e njohin këtë praktikë. Këtë mundësi e parashikon edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu, sipas nenit 47 të Konventës: “1.Gjykata, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, mund të japë mendime konsultative për çështje ligjore që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj; 2.Gjykata ose Komiteti i Ministrave nuk mund të japin mendime konsultative... as për çështje të tjera që atyre u duhet të shqyrtojnë për shkak të procedurave të filluara në përputhje me Konventën”.

Në kushtet e mësipërme, megjithëse nuk ka bazë kushtetuese që Gjykata të japë opinione konsultative, mendoj se ka edhe një rrethanë tjetër pse kjo gjë mund të refuzohej.

Le t’u kthehemi edhe një herë rrethanave të çështjes. Kuvendi filloi procedurën e propozimit për shkarkim, në bazë të nenit 149 pika 2 të Kushtetutës, por ndërkohë kërkohet interpretimi i dispozitave në Gjykatën Kushtetuese. Pa përfunduar çështja e interpretimit, finalizohet procedura e shkarkimit dhe Dekreti i Presidentit të Republikës kundërshtohet po në këtë Gjykatë si antikushtetues. Pra, në kushtet kur u paraqit edhe kërkesa e dytë për anulimin e dekretit, ndërkohë që çështja e parë ishte në dorë, po të aplikohet me analogji pika 2 e dispozitës së mësipërme të Konventës Evropiane, Gjykata Kushtetuese mund të mos e pranonte kërkesën për interpretim.

ANËTAR
P. Piloçi

V E N D I M
Nr. 76, datë 25.4.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ““
Alfred Karamuço	Anëtar i ““
Kristofor Peçi	Anëtar i ““
Kujtim Puto	Anëtar i ““
Tefta Zaka	Anëtare e ““
Petrit Piloçi	Anëtar i ““
Sokol Sadushi	Anëtar i ““
Gjergj Sauli	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 8.4.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.78 Akti që i përket:

KËRKUES: ARBEN RAKIPI, përfaqësuar nga avokatët Vangjel Kosta e Edmond Icka.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.
2. PRESIDENTI I REPUBLIKËS, përfaqësuar nga Vjollca Uruçi.
3. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE, përfaqësuar nga kryetari, zoti Arben Malaj.
4. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit nr.20, datë 19.3.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe i Dekretit nr.3276, datë 25.3.2002 të Presidentit të Republikës.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 42, 131 shkronja “f”, 134/1 shkronja “g”, 134/2 e 149/2 të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar në kërkesën e paraqitur se gjatë procedurës për nxjerrjen e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë dhe të Dekretit të Presidentit të Republikës për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese e ligjore nga një proces i parregullt ligjor, në këto drejtime kryesore:

- Nuk është informuar për natyrën dhe shkakun e shkarkimit nga detyra;
- nuk i është dhënë koha e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- nuk i është dhënë mundësia për t’u dëgjuar dhe mbrojtur.

Presidenti i Republikës, në pozitën e subjektit të interesuar, ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe se kjo Gjykatë nuk është kompetente të shqyrtojë çështjen.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.20, datë 18.3.2002, Kuvendi i Shqipërisë, ka vendosur t’i propozojë Presidentit të Republikës, shkarkimin e kërkuesit Arben Rakipi nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm, “për akte e sjellje që kanë diskredituar rëndë pozitën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës së tij”. Mbi bazën e këtij propozimi, Presidenti i Republikës me Dekretin nr.3276, datë 25.3.2002, bazuar në nenin 149/2 të Kushtetutës, ka shkarkuar nga detyra Prokurorin e Përgjithshëm me motivacionin, “për akte e sjellje që kanë diskredituar rëndë pozitën e prokurorit”.

Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme që, para se të analizojë pretendimet e kërkuesit, të shqyrtojë dhe të mbajë qëndrim ndaj pretendimeve të bëra nga përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, si subjekt i interesuar, veçanërisht lidhur me kompetencën e Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e kësaj çështje, si dhe me legjitimitimin e kërkuesit për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë.

Pretendimi i subjektit të interesuar se Gjykatës Kushtetuese i mungon kompetenca e gjykimit të kushtetutshmërisë së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk është i bazuar. Është e vërtetë që në bazë të neneve 90, 115, 128, 140 të Kushtetutës, Gjykatës Kushtetuese i është dhënë kompetenca të shqyrtojë shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës, të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, të anëtarit të Gjykatës së Lartë e të organeve të qeverisjes vendore, por kjo nuk do të thotë se ky organ nuk ka të drejtë të shqyrtojë ankesat kushtetuese në raste të tjera të parashikuara nga kjo Kushtetutë.

Detyra themelore e Gjykatës Kushtetuese, si garant i respektimit të Kushtetutës, nuk mund të interpretohet e kuptohet e kufizuar vetëm në raport me organet apo funksionet e sipërpërmendura, por edhe me çdo individ, kur janë kushtet e shkronjës “f” të nenit 131 të Kushtetutës.

Duke ju referuar përmbajtjes së neneve 131 shkronja “f” dhe 134 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, arrihet në konkluzionin se ndërsa për rastet e subjekteve të pretenduara më sipër, Gjykata Kushtetuese shqyrton si themelin e çështjes ashtu dhe procedurën e zbatuar, në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili pas shkarkimit nga detyra paraqitet si individ, ajo ushtron kontrollin kushtetues vetëm mbi zbatimin e parimit themelor për një proces të rregullt ligjor.

Ndaj pretendimit tjetër të subjektit të interesuar sipas të cilit Prokurori i Përgjithshëm nuk legjitimohet të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me rastin e shkarkimit të tij nga Presidenti i Republikës, kjo Gjykatë parashtron një sërë argumentesh duke u mbështetur në dispozitat e Kushtetutës, në dokumentet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e saj.

Në bazë të neneve 131 shkronja “f” dhe 134 shkronja “g” të Kushtetutës, çdo individ ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese kur ai mendon se nga shkelja e parimit për një proces të rregullt ligjor, atij i janë cenuar të drejtat kushtetuese e ligjore dhe kur i janë shterur mjetet e tjera juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. E drejta për të qenë Prokuror i Përgjithshëm sigurisht që nuk është një e drejtë themelore, por nga ky pozicion rrjedhin një sërë të drejtash kushtetuese e ligjore për individin, të cilat synon t’i mbrojë neni 42/1 i Kushtetutës nëpërmjet procesit të rregullt ligjor.

Subjekti i interesuar pretendon gjithashtu se dispozita e mësipërme mbron vetëm të drejtat e individëve dhe jo të individëve që kanë qenë të veshur me pushtet publik, duke iu referuar një qendrimi të mbajtur nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen “Pellegrin kundër Francës”.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të theksojë se çështja “Pellegrin kundër Francës” e referuar qoftë edhe si bazë për të nxjerrë përfundime teorike, dëshmon të kundërtën e asaj që pretendohet nga subjekti i interesuar. Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, problemin e legjitimitetit e ka ngritur si çështje në lidhje me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe me rastin në gjykim, por jo në raport me të Drejtën Kombëtare. Fakt është se Pellegrin, për të cilin Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ngre problemin e legjitimitetit për nëpunësin publik, e kishte ushtruar të drejtën për t’u gjykuar në të gjithë hallkat e sistemit gjyqësor të vendit të tij.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në çdo rast Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut vendos standardet e domosdoshme dhe garancitë që çdo shtet kontraktues duhet të sigurojë për të realizuar një proces të rregullt ligjor dhe jo rrethin e personave që duhet të përfitojnë prej saj. Ajo çmon se procesi i rregullt ligjor zbatohet për të gjitha konfliktet që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi qoftë ai edhe funksionar publik. Pra, Gjykata Kushtetuese e shikon pozicionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që i siguron Kushtetuta, jurisprudenca e saj e deritanishme dhe fryma e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese ka parasysht edhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ, siç është rasti në shqyrtim.

Në kundërshtim me sa pretendohet nga subjekti i interesuar se kërkuessit nuk i janë shteruar mjetet e tjera juridike për të mbrojtur të drejtat e tij, Gjykatat Kushtetuese konkludon se Dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtohen nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm.

Veçantia e këtij Dekreti të Presidentit të Republikës qendron në faktin se ai është i lidhur pazgjidhshmërisht me procedurat parlamentare, në bazë të të cilave ka dalë vendimi propozues i Kuvendit, që është një premisë e domosdoshme për nxjerrjen e Dekretit. Nga kuptimi i neneve 324-333 të Kodit të Procedurës Civile rezulton se nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme aktet me karakter administrativ të kësaj natyre, të cilat janë rezultat i procedurave parlamentare.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese i konsideron të shteruara mjetet juridike që duhet të përdor kërkuessi për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me pretendimin e kërkuessit se është zhvilluar një proces i parregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tij nga detyra, Gjykata Kushtetuese çmon të theksojë se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë.

Në vendimin interpretues nr.75, datë 19.4.2002, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qendrimin e saj lidhur me kuptimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke arsyetuar se njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merrret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cenimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.

Duke iu referuar çështjes në shqyrtim, Gjykatës Kushtetuese i rezulton se Kuvendi, gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk i është përmbajtur pikërisht respektimit të këtyre standardeve. Kështu Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena të gjitha akuzat e drejtuara ndaj kërkuesit, duke u mbështetur vetëm në diskutimet e deputetëve, pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kërkuesin për përmbajtjen e materialit në ngarkim të tij, pa i dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe pa e dëgjuar atë për të parashtruar prapësimet rreth këtyre akuzave.

Konkretisht, seanca e debatit për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm u zhvillua në mbasditen e datës 18.3.2002 dhe vazhdoi pa ndërprerje deri në orët e para të datës 19.3.2002. E gjithë procedura u zhvillua rreth një relacioni që shoqëronte pvojektvendimin, sepse vetëm në të e jo në mocion përmendeshin shkaqet konkrete, për të cilat kërkohesh shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm nga detyra. Është e vërtetë që kërkuesi është njoftuar nga Kryetari i Kuvendit me shkresën nr.434/2, datë 18.3.2002 për debatën që do të zhvillohej, por ky njoftim, që më shumë është një ftesë për të asistuar në Kuvend, iu dorëzua me mocionin përkatës disa orë përpara debatit, pa u shoqëruar me materialet për shkaqet konkrete në ngarkim të tij, për të cilat ai kërkohesh të shkarkohesh nga detyra. Gjithashtu, krahas njoftimit të mësipërm, në të njëjtën datë, më 18.3.2002, kur do të zhvillohej mocioni për debat, kërkuesit i është dërguar nga Kuvendi një shkresë e dytë me nr.683 Prot, me të cilën njoftohesh se në orën 17.00 të kësaj date, të paraqitej në Kuvend për shqyrtimin e një materiali të Prokurorisë, pra për një çështje tjetër, që nuk kishte lidhje me mocionin për shkarkimin nga detyra. Në këtë mënyrë, kërkuesi është vënë në pamundësi reale për të realizuar të drejtën e tij të mbrojtjes.

Pavarësisht nga mënyra e rregullimit në Kushtetutë apo në ligj të procedurave për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese thekson se Kuvendi nuk pengohesh të adoptonte rregulla që ai mendonte se ishin të zbatueshme për rastin konkret, por gjithmonë duke respektuar parimin kushtetues, atë të një procesi të rregullt ligjor.

Me këto shkelje është pajtuar edhe Presidenti i Republikës, i cili ka miratuar propozimin e Kuvendit për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm. Procedura e ndjekur nga Presidenti përmban të njëjtët elementë që kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kërkuesi është thirrur nga Presidenti para dekretimit të shkarkimit nga detyra, por nuk rezultoi që ai të jetë njohur më parë me materialin që përmbante shkaqet e shkarkimit të tij nga detyra, apo që t'i jetë dhënë koha e nevojshme për t'u përgatitur për mbrojtje, me qëllim që Presidenti i Republikës, në përputhje me Kushtetutën, të kishte mundësinë për të ushtruar kompetencat e tij vendimmarrëse ndaj vendimit propozues të Kuvendit.

Dekreti i Presidentit dhe Vendimi i Kuvendit, që janë objekt kundërshtimi në këtë gjykim, ndonëse i përkasin dy organeve të ndryshme kushtetuese, janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe përfaqësojnë një proces të pandashëm. Megjithatë kjo lidhje jo vetëm nuk prek të drejtën e Presidentit që të verifikojë vendimin e Kuvendit, por e presupozon dhe e bën të domosdoshëm këtë verifikim.

Ky qëndrim është mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj interpretues nr.75, datë 19.4.2002, në të cilin thuhesh se, përsa i përket nenit 149 pika 2 të Kushtetutës, "Gjykata Kushtetuese çmon se është Presidenti i Republikës organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer një verifikim nga pikëpamja kushtetuese të shkaqeve si dhe procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Ky konkluzion del nga mënyra e formulimit të këtij neni kushtetues në të cilin përdorimi i shprehjes “mund të shkarkohet” do të thotë se vendimi i Kuvendit për propozimin e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk është përfundimtar, por është vetëm inicimi i një procedure shkarkimi, bazueshmëria në ligj e në Kushtetutë e të cilës vlerësohet në këtë rast nga Presidenti i Republikës”.

Prandaj roli i Presidentit në këtë rast është përcaktues. Detyra e tij si përfaqësues i unitetit të popullit është të mbikqyrë funksionimin normal të mekanizmave kushtetuese, duke ndërhyrë për eliminimin e mangësive në këtë drejtim.

Si konkluzion, duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese nuk mori në shqyrtim se sa të bazuara në ligj dhe në fakt ishin aktet dhe sjelljet diskredituese të pozitës së Prokurorit të Përgjithshëm, sepse ato kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes konkrete. Ajo në ushtrim të plotë të kompetencave të saj shqyrtoi kushtetutshmërinë e procedurave të shkarkimit dhe konkludon se ato kanë qenë në kundërshtim me parimet kushtetuese. I përket Kuvendit të Shqipërisë të riparojë këto shkelje, duke rishqyrtuar çështjen në përputhje me parimet kushtetuese dhe normat e gjithpranuara ndërkombëtare për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f”, 132, 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të Vendimit nr.20, datë 19.3.2002 të Kuvendit të Shqipërisë dhe të Dekretit nr.3276, datë 25.3.2002 të Presidentit të Republikës.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

1. Sipas Kushtetutës, prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor pra, ajo nuk bën pjesë në pushtetin gjyqësor. Në bazë të këtij pozicioni, Kushtetuta ka bërë edhe dallimin e këtij organi me organet e tjera për mënyrën e funksionimit, imunitetit e kompetencave, etj.

Ky dallim gjen pasqyrim në Kushtetutë edhe në mënyrën e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu, për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa për Prokurorin e Përgjithshëm vendos Presidenti i Republikës. Dallim ka edhe përse i përket shkaqeve të shkarkimit. Për gjyqtarët (nenet 128 e 140) një ndër shkaqet është kryerja e një krimi. Kjo për Prokurorin e Përgjithshëm është zëvendësuar me shprehjen “për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij”. Një ndryshim i tillë nuk është i rastit, por ka një qëllim të caktuar që lidhet me pozitën e veçantë të Prokurorit të Përgjithshëm në dallim nga përfaqësuesit e tre pushteteve. Këtë dallim e bën edhe neni 141 i Kushtetutës lidhur me juridiksionin fillestar të Gjykatës së Lartë për akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por nuk përmendet Prokurori i Përgjithshëm. Gjyqtarët e kësaj kategorie kanë afat emërimi dhe kritere për mbarimin e mandatit, gjë që nuk i ka Prokurori i Përgjithshëm.

Nga krahasimi i këtyre neneve të Kushtetutës del që Prokurori i Përgjithshëm ka jo vetëm një pozicion të veçantë, por edhe një mbrojtje të tillë në dallim nga këto organe të tjera. Kjo del edhe nga përmbajtja e nenit 56 të ligjit “Për Prokurorinë”, etj., që e vë këtë organ pothuaj në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Përsa i përket emërimit dhe shkarkimit të organeve kushtetuese, në Kushtetutë mbahen qendrimet të ndryshme në varësi të pozitës, kompetencave dhe funksioneve të tyre (për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, i përmendëm). Për Avokatin e Popullit, pozita dhe funksioni i të cilit është në oponentë me degët e pushtetit dhe organeve të tjera, Kushtetuta ka vënë kritere rigoroze për shkarkim: me kërkesë të motivuar të jo më pak se 1/3 së deputetëve dhe Kuvendi vendos me 3/5 e anëtarëve të tij. Po kështu procedura rigoroze ka për shkarkimin e Presidentit të Republikës, por, për organe të tjera kushtetuese, mbahet qëndrim tjetër. Psh., Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit (nuk thuhet se si), ose për Guvernatorin e Bankës, Kushtetuta përmend vetëm zgjedhjen nga Kuvendi me propozim të Presidentit, pa folur fare për shkarkimin. Qendrim tjetër mban Kushtetuta për organe që janë në varësi të degëve të pushtetit. P.sh., Shefi i Shtabit të Përgjithshëm emërohet e shkarkohet nga Presidenti me propozim të Kryeministrit, po kështu edhe përfaqësuesit diplomatikë. Edhe për këto kategori organesh mbahet qëndrim i njohur që flitet vetëm për emërimin dhe jo për shkarkimin. Psh., Drejtori i ShISH, Kryetari i Akademisë së Shkencave ose rektorët e universiteteve.

Për rastet kur Kushtetuta nuk përmend shkarkimin, nuk do të thotë se këto organe nuk mund të shkarkohen, por nisur nga shkalla e rëndësisë dhe funksionit të tyre, ka lënë që ky problem të rregullohet me ligj.

3. Duke bërë një parashtrim të tillë të pozitës, emërimit dhe shkarkimit të këtyre organeve, lind pyetja se çfarë procedurash duhen ndjekur dhe nëse mund të zbatohen këtu parimet dhe elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues? Kam mendimin se ky nuk është një problem i lehtë dhe që mund të zgjidhet menjëherë, pa asnjë mëdyshje, qoftë edhe me një interpretim të zgjeruar, i cili ndoshta, mund të rezultojë i sforcuar.

Por le t'i referohemi edhe njëherë Kushtetutës, duke e lidhur me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Kjo Gjykatë duke shqyrtuar vendimin e Kuvendit për rastet e parashikuara nga nenet 128 e 140 të Kushtetutës (rastet e shkarkimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë e atyre Kushtetues), bën një gjykim themeli duke vendosur përfundimisht shkarkimin ose qëndrimin në detyrë. Këtë e thotë vetë Kushtetuta kur shprehet: “... e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin”. Këtu Kushtetuta nuk përmend fare procedurë, por verifikim të shkaqeve dhe nuk thotë “vendos” por “deklaron shkarkimin”, duke nënkuptuar një miratim të vendimit të Kuvendit.

E njëjta gjë përsa i përket kompetencës së Gjykatës Kushtetuese mund të thuhet edhe për rastet e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës për shkarkim të organeve të qeverisjes vendore, edhe këtu Gjykata Kushtetuese e zgjidh çështjen në themel dhe si gjykatë e shkallës së parë.

Ndryshe qendron çështja për Prokurorin e Përgjithshëm, ku sipas Kushtetutës vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Presidenti e jo nga Gjykata Kushtetuese. Fakti që Kushtetuta përmend shprehimisht shkaqet e shkarkimit, nuk ka të bëjë me kompetencën, sepse kjo është dhe mbetet e dy organeve, Kuvendit e Presidentit, por ka një qëllim të caktuar, atë të mbrojtjes së veçantë të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili nuk mund të shkarkohet për shkaqe të tjera, por, gjithsesi, vlerësimin e bën organi kompetent që në rastin konkret është Kuvendi dhe Presidenti i Republikës. Në këtë rast, është e qartë që Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë në shqyrtim ekzistencën ose jo të shkaqeve, sepse këtë kompetencë nuk ia ka dhënë Kushtetuta, si në rastet e tjera që përmenden për të bërë gjykim themeli. Mund të shtrohet pyetja: po në rast se Kuvendi e Presidenti bëjnë vlerësim të gabuar të shkaqeve si do të bëhet? Them se këto organe si organet më të larta të shtetit kanë kompetencën kushtetuese dhe njëkohësisht përgjegjësinë e madhe për vendimet që marrin, por as Gjykata Kushtetuese dhe as një organ tjetër këtu nuk mund të ndërhyjnë (është fjala për themelin e çështjes).

4. Tani të vimë tek një problem tjetër që ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor dhe me shkeljen ose jo të të drejtave kushtetuese. Nisur nga kompetenca që ka Gjykata Kushtetuese për të shqyrtuar kërkesa të tilla, shtrohet pyetja: a janë shkelur në rastin konkret të drejtat kushtetuese?

Mendoj se posti publik që ka një funksionar i lartë shtetëror nuk është e drejtë kushtetuese. Për më tepër ky post nuk është vetëm e drejtë por edhe detyrë. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese investohet për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Formulimi i këtij neni ka ndryshim nga përmbajtja e nenit 42/1 të Kushtetutës ku përcaktohet se nuk mund të cenohen pa proces të rregullt edhe të drejtat e njohura me ligj. Dallimi është se Gjykata Kushtetuese mund të marrë në shqyrtim vetëm rastet kur nga një proces ligjor i parregullt janë shkelur të drejtat kushtetuese, ashtu siç thuhet në nenin 131/f të Kushtetutës.

Mund të mendohet se këtu është cenuar dinjiteti i personit që përmendet në nenin 3 të Kushtetutës. Por, ky nen, që është në pjesën e parë të Kushtetutës, trajton parimet themelore, ashtu siç e ka edhe titullin, ndërsa të drejtat dhe liritë themelore të njeriut trajtohen në pjesën e dytë (neni 15 e vijues), ku saktësohen liritë dhe të drejtat konkrete. Sipas nenit 35/2 të Kushtetutës, mbledhja përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit, bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Një nga këto raste të parashikuara me ligj (bile me Kushtetutë) është dhe verifikimi i shkaqeve për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, aq më tepër që në këtë rast nuk kemi të bëjmë vetëm me të dhëna rreth personit, por të lidhura me kryerjen e funksioneve të rëndësishme publike, plotësimi i të cilave është jo vetëm e drejtë por edhe detyrim.

Këto janë disa nga shkaqet që të çojnë në përfundimin se verifikimi i procedurave për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese përderisa nuk ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor në aspektin kushtetues.

Pranimi i të kundërtës nuk i qendron logjikës dhe do të kthehej në një paradoks, sepse nga njëra anë pranohet se Gjykata Kushtetuese nuk shqyrton themelin e çështjes, pra bazueshmërinë ose jo të shkaqeve (gjë që është plotësisht e drejtë dhe e bazuar në Kushtetutë), dhe nga ana tjetër argumentohet se jemi para procesit të parregullt pasi nuk janë zbatuar disa elementë të tij për verifikimin e këtyre shkaqeve. Për të përcaktuar këta elementë, referimi bëhet në parimet e procesit të rregullt ligjor, në mënyrë teorike pa e lidhur me shkeljet konkrete.

Gjithashtu vlen të theksohet se në parimet themelore në lidhje me pavarësinë e drejtësisë, të miratuar nga Kongresi i 7-të i Kombeve të Bashkuara, në pjesën për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve thuhet: “Duhet të përcaktohen dispozita të përshtatshme me qëllim që një organ i pavarur të ketë kompetencë për të rishikuar vendimet që merren lidhur me masat disiplinore, të pezullimit ose shkarkimit. Ky parim mund të mos zbatohet për vendimet që merren nga një juridiksion suprem ose pushteti legjislativ në kuadrin e një procedure gati gjyqësore”. Po t’i referohemi Kushtetutës tonë, del se për rastin e gjyqtarëve është zbatuar rregulli e jo përjashtimi, sepse vendimi për shkarkimin e tyre i nënshtrohet rishikimit nga një organ kompetent i pavarur (sipas rastit Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ose Gjykata Kushtetuese). Por, edhe për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm është afërsisht e njëjta gjë, sepse vendimi i Kuvendit rishikohet nga një organ kompetent i pavarur siç është Presidenti i Republikës. Tani të kthehemi tek përjashtimi nga rregulli që lidhet me një juridiksion suprem ose pushtetin legjislativ. Kur deklarata pranon këtë përjashtim për gjyqtarët, të cilët kanë mbrojtje të veçantë për shkak të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së drejtësisë, është e kuptueshme që do të pranohet më lehtë edhe për raste të tjera. Sipas Kushtetutës tonë raste që lidhen me një juridiksion suprem do të ishin edhe shkarkimi nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ose ambasadorëve, për të cilët as bëhet ankim në Gjykatë dhe as mund të investohet Gjykata Kushtetuese për proces të parregullt, sepse largimi nga poste të tilla publike nuk prek ndonjë të drejtë kushtetuese.

Nisur nga fakti që në Kushtetutë, shkaqet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm janë të përafërta me ato të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e të Gjykatës së Lartë, do të ishte me vend që edhe mënyra e shkarkimit të ishte e përafërt dhe të mos linte shteg për ekuivoqe ose keqinterpretime. Por, përderisa Kushtetuta jonë mban një qendrim tjetër, është e pamundur të pranohet varianti për proces të parregullt. Kjo për faktin se çështja nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese kur bëhet fjalë për poste publike që mbajnë funksionarët e lartë shtetërorë, shkarkimi nga të cilat nuk prek të drejtat kushtetuese sipas nenit 131/f të Kushtetutës.

ANËTAR
K. Peçi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 2.5.2002
Doli nga shtypi më 10.5.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë